



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GRUPI TEMATIK ANTIKORRUPSION/KOMITETI KOORDINATOR PËR
ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT**

Nr. 3174 Prot.

Tiranë, më 17. 06. 2021

VENDIM

Nr. 17, datë 17. 06. 2021

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT JANAR-MARS 2021 NË
ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT
2015-2023**

Në mbështetje të Vendimit Nr. 516, datë 1.07.2020, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020”, dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020 – 2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023, e të Pasaportës së Indikatorëve”, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike Nr. 80, datë 17.11.2020 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe periudhës së kohëzgjatjes së vitit shkollor 2020-2021”, Grupi Tematik Antikorrupsion/Komiteti Koordinator

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Monitorimit Janar – Mars 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, në mbledhjen e zhvilluar *online*, nëpërmjet platformës Zoom, datë 17.06.2021, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të publikojë Raportin e Monitorimit Janar - Mars 2021 në faqen e saj zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Ministri i Drejtësisë

Etilda Gjohaj (Saliu)





KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

RAPORT

MONITORIMI PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2021

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2023

www.drejtesia.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	5
- <i>Përmbledhje ekzekutive mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit për janar-mars 2021.....</i>	6
- <i>Realizimi i rekomandimeve të lëna për zbatim në raportin vjetor 2020.....</i>	9
- <i>Metodologjia e hartimit të raportit të monitorimit</i>	11
- <i>Matrica e riskut.....</i>	13
- <i>Konsultimi publik</i>	14
 PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT.....	15
- <i>Masa dhe aktivitete të implementuara me sukses në periudhën përkatëse.....</i>	15
- <i>Statusi i masave dhe aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet).....</i>	18
- <i>Statusi i aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet).....</i>	19
- <i>Statusi i masave që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet).....</i>	20
- <i>Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur masat dhe aktivitetet</i>	21
- <i>Histori suksesi (përmes masave priritare)</i>	21
 EKZEKUTIMI I BUXHETIT	24
 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	25
- <i>Rekomandime</i>	25
- <i>Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit</i>	26
- <i>Vlerësimi i riskut duke përdorur masat dhe aktivitetet</i>	27
- <i>Hapat e rradhës.....</i>	28

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ASHSGJ	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronave
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
GTA	Grupi Tematik për Antikorrupsionin
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
IML	Instituti i Mjeksisë Ligjore
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimit
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit

QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
SHKBB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

HYRJE

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi. Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë. Qeveria ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere.

Përparësia e qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritetit evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, etj.

Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Me Vendimin nr. 516, datë 1.7.2020 të Këshillit të Ministrave afati i zbatimit të SNKK u zgjat deri në vitin 2023. Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*. Qëllimet madhore politikës së Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit. Këto qëllime politikash (qasje) janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023, përmban 18 objektiva specifike, të cilët janë:

Parandalim:

- A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion
- A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike
- A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike
- A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit
- A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave
- A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike
- A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut
- A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion
- A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë
- A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

A.11 Adoptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore

Ndëshkim:

- B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit
- B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit
- B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar
- B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit.

Ndërgjegjësim:

- C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit
- C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit
- C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Përmbledhje ekzekutive mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit për janar-mars 2021

Plani i Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023, parashikon masa dhe aktivitete specifike që duhen të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave, sipas afateve të detajuara në të.

Ky raport monitorimi, *janar – mars 2021*, paraqet vetëm realizimin e masave dhe aktiviteteve (produkteve) të Planit të Veprimit. Raporti identifikon progresin dhe ecurinë e zbatimit të masave për këtë periudhë monitorimi, duke marrë në konsideratë dhe vlerësim realizimin e tyre, shkallën e performancës së aktiviteteve të institucioneve që raportojnë aktiviteteve dhe masa në proces zbatimi dhe uljen e numrit të masave të pazbatuara.

Raporti identifikon arritjen e rekomandimeve dhe hapat për zbatimin e tyre, referuar rekomandimeve të lëna në raportin vjetor të monitorimit 2020. Në këtë analizë ofrohet gjithashtu informacioni për të parë relevancën e përmbajtjes së këtij plani veprimi përkundrejt arritjes së indikatorëve të parashikuar në Pasaportën e Indikatorëve, të objektivëve specifikë dhe të qëllimit madhor, atë të arritjes së qëllimeve të politikave (qasjeve) të Strategjisë, parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim.

Ky raport krijon dhe vendos të gjithë infrastrukturën analitike që rekomandimet e lëna të trajtohen në raportet pasardhës.

Për këtë periudhë monitorimi, *janar – mars 2021*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 60 masa e 106 aktivitete, të shpërndara përkatësisht në 31 masa e 57 aktivitete për qasjen parandaluese (A), 20 masa e 29 aktivitete për qasjen ndëshkuese (B) dhe 9 masa e 20 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuere (C).

Përmes zbatimit të Planit të Veprimit për periudhën *janar – mars 2021*, janë zbatuar plotësisht 27 masa, pjesërisht 15 masa dhe nuk janë zbatuar 18 masa si dhe janë zbatuar plotësisht 51 aktivitete, pjesërisht 17 aktivitete dhe të pazbatuara janë 38 aktivitete.

Në vijim paraqitet realizueshmëria e objektivëve të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave dhe aktiviteteve:

Objektivat		Shkalla e realizimit sipas masave
Parandalimi	A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	31 në 50 për qind e masave të zbatuara
	A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara
	A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	31 në 50 për qind e masave të zbatuara
	A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara
Ndëshkimi	B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërkohërisht penal të korrupsionit	31 në 50 për qind e masave të zbatuara

	B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	— ¹
	B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit	0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara
Ndërgjegjësimi	C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.	0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara

Për këtë periudhë *janar – mars 2021*, janë shënuar arritje në qëllimet e politikës (qasjen) parandaluese (A), ndëshkuese (B) dhe ndërgjegjëse (C) të zbatimit të strategjisë, më konkretisht përmendim:

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit vijon shtimin e shërbimeve elektronike me një numër total prej 1 207, numri i përdoruesve të regjistruar 1 938 002 dhe numri i aplikimeve (portali +moduli) 11 646 773 si edhe me kryerjen e zhvillimeve teknike; vetëm për këtë 3-mujor janë vënë në shërbim 186 e-shërbime, në fusha si : arsimi/ shëndetësia/turizmi/infrastruktura/ kultura/ shërbimet mbështetëse/shërbimet financiare;
- Agjencia e Prokurimit Publik ka vijuar me forcimin e kapaciteteve të stafit teknik, 3 persona, mbi aktivitete operacionale të saj, të zhvilluara online (webinare) dhe në sesione informuese mbi kuadrin ligjor të fushës; është nxjerrë 1 rekomandim për autoritetet kontraktore;
- Viojnë bashkëpunimet e ndërsjellta PSH-SHCBA me qëllim trajnimin e denoncimeve kundër korrupsionit, 1 rast i përbashkët i PSH me SHCBA e finalizuar në DVP Korçë, ku janë arrestuar 5 shtetas nga të cilët 2 janë punonjës policie; forcim kapacitetesh të punonjësve të të dy strukturave, nga Pameca dhe Prokuroria e Përgjithshme; janë në përdorim të plotë të gjitha portat e komunikimit në dispozicion, 20 raste për 35 punonjës policie, për shkeljet e evidentuara është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, në Policinë e Shtetit;
- ILDKPKI ka ndërmarrë komunikime me të gjitha Autoritetet Përgjegjëse pranë institucioneve publike dhe janë mbledhur të dhënat e nevojshme për të ngritur regjistrin elektronik të tyre, si dhe janë zhvilluar modulet e nevojshme për të filluar pilotimin fillimisht pranë Inspektoratit të Lartë;
- Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë kanë filluar me procesin e vlerësimit të riskut të integritetit, në përputhje me dokumentin “Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

¹Ky objektiv nuk është matur pasi e fillon zbatimin në tremujorët e tjerë të 2021.

në Institucionet Qëndrore” nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë (dy takime të dedikuara në grup informuese/ndërgjegjëse me përfaqësues e punonjës së varësive të MD);

- Janë zhvilluar operacione të sukseshme të hetimeve proaktive PSH-SHCBA: 4 operacione për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së punonjësve të policisë në format dhe fenomenet më shqetësuese, siç janë *“korrupsioni pasiv”, “shpërdorimi i detyrës”, favorizimi i “kultivimit të bimëve narkotike” e “kontrabandës”, “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit” etj.*
- Vijon bashkëpunimi i institucioneve ligjzbatuese me SPAK, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë dhe strukturave të Policisë së Shtetit, duke u finalizuar me dokumentimin me prova ligjore të veprimtarisë së kundërligjshme të 8 punonjësve të policisë dhe 25 shtetasve të implikuar, si dhe ekzekutimit të masave të sigurimit personal shtrëngues dhe ndalues të dhëna për ta si subjekte të procedimeve penale në ndjekje.
- Është lidhur marrëveshje bashkëpunimi Prokurori e Përgjithshme - Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektiveve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve “Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në bazën e të dhënave menaxhimi i informacionit të sistemit penitenciar” e cila është në proces aksesimi teknik;
- Vijon bashkërendimi dhe vendosja e bashkëpunimit të MD/KKK me partnerë në fushën e ndërgjegjëzimit të publikut në luftë kundër korrupsionit. Marrëveshje bashkëpunimi MD-MASR-Ambasada e Italisë në Shqipëri, për promovimin e përbashkët të një projekti pilot didaktik-edukativ (moduli antikorrupsion) për mësuesit e arsimit të mesëm e të ulët; është kryer promovimi dhe njohja me publikun e gjerë për adresimin e ankesave për raste korruptive pranë Koordinatorëve të Rrjetit Antikorrupsion;
- Janë përmirësuar proceset në sistemin elektronik të platformës së bashkëqeverisjes, www.shqiperiaqeduam.al, duke mundësuar gjurmimin dhe etiketimin elektronik të rasteve të dyshuara si korruptive; janë regjistruar 7 057 çështje, kërkesa, ankesa, nga të cilat 5 052 përkasin autoriteteve në nivel qendror dhe 1 253 në nivel vendor dhe 752 janë për çështje biznesi.

Realizimi i rekomandimeve të lëna për zbatim në raportin vjetor 2020

Për këtë periudhë *janar – mars 2021*, ka një ecuri dhe përmirësim në kryerjen e masave dhe aktiviteteve me qëllim plotësimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e mëparshëm të monitorimit (vjetor 2020), ku përmendim përkatësisht objektivet A4, A5, A6, vijueshmërinë e objektivëve A8 e A9, forcimin e bashkëpunimit institucional të nevojshëm nën objektivet B. Mbetet problematikë moszbatimi i masave dhe aktiviteteve nën objektivat A11 e C3.

Ndërkohë edhe për këtë periudhë raportimi ka masa dhe aktivitete për të cilat mungon raportimi mbi zhvillimin e tyre (4 masa dhe 14 aktivitete) dhe atë të buxhetit të përdorur (17 masa dhe 26 aktivitete).

Por, nga monitorimi dhe vlerësimi i kryer, rezulton se institucionet duhet të aktivizojnë rolin e tyre në këtë plan veprimi me qëllim arritjen e vlerave të synuara në treguesit e parashikuar për vitin 2021, pasi duhet të fillojë, të vijojë dhe intensifikohet kryerja e tyre që kanë një impakt më të ndjeshëm në arritjen e treguesve, sic mund të përmenden objektivet A1, A2, A5, A6, A7, A11, objektivet B, C2 e C3.

Krahasuar me periudhën janar - mars 2020 të monitorimit, ka një ecuri zbatimi, dhe kryesisht në masa dhe aktivitete të parashikuara për objektive në të tre qëllimet e politikave (qasje) të SNKK, parandaluese – ndëshkuese – ndërgjegjëse.

Objekti A3 ka një shkallë realizueshmërie më të mirë, me 186 e-shërbime të shtuara në vetëm këtë 3-mujor të parë të vitit duke realizuar kështu vlerën e synuar për vitin 2021; në objektivet A2 e A4 janë përmirësuar kapacitetet e institucioneve zbatuese krahasueshmërisht me periudhën e kaluar 2020; ka vijueshmëri bashkëpunimi ndërmjet organeve ligjzbatuese, por për këtë periudhë raportimi është përfshirë edhe SPAK; vizibiliteti dhe ndërgjegjësimi i publikut në luftë kundër korrupsionit është i shtuar me përpjekje për marrëveshje bashkëpunimi me partnerë të fushave të ndryshme; transparenca dhe publikimi i akteve të KKK paraqitet i njëjtë.

Plani i Veprimit 2020-2023 është një dokument i rishikuar, për nga përmbajtja në masa dhe aktivitete, ndaj dhe nuk mund të afrohet plotësisht një krahasim i tij me të njëjtin raport dhe/apo periudhë të vitit të kaluar.

Si përfundim, për këtë periudhë raportimi vijnë të adresohen si sfida kryesore në zbatimin e planit të veprimit, çështje si:

- pamjaftueshmëria dhe paqëndrueshmëria e burimeve financiare në krijimin e mundësive për zbatimin e aktiviteteve dhe masave;
- ndikimi i mjedisit të jashtëm siç mund të jenë vendime politike apo problemet me kapacitetet audituese;
- çështje që lidhen me komunikimin dhe informimin, proceset operacionale dhe sistemet;
- çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ të brendshëm;
- çështje që lidhen me komunikimin, informimin dhe bashkëpunimin ndërinsitucional në përgjithësi;
- çështje të tjera që lidhen me kapacitetet administrative;
- çështje që lidhen me partnerët e jashtëm si dhe rreziqe që lidhen me planifikimin, proceset, sistemet IT dhe sistemet e tjera mbështetëse;
- efektet e Pandemisë Covid-19 mbi objektivat strategjike dhe duke u kthyer në pengesë kryesore për progresin e tyre,

faktorë këto që kanë patur ndikimin e tyre në ecurinë e deritanishme të zbatueshmërisë së masave dhe aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit.

Metodologjia e hartimit të raportit të monitorimit

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 114, dt. 04.09.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Programeve në Fushën

Antikorrupsion, pranë Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve periodike të Monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 - 2023.

Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion (DPFFA) kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën *1 janar deri më 31 mars 2021* dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit 2020- 2023 të SNKK-së. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Monitorimi i Strategjisë ka konsistuar në dy faza kryesore:

1. Raportimi i institucioneve nëpërmjet pikave të kontaktit antikorrupsion, mbi zbatimin e masave për të cilat janë përgjegjëse; dhe
2. Raportimi nga KKK mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij.

Secili institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo qëllimi politike, objektivi specifikë, masash të zbatuara (mbi bazë aktivitetesh të kryera), buxhetin e parashikuar për periudhën raportuese, buxhetin e alokuar për periudhën e raportimit, problemet e hasura, hapat e mëtejshme dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përse i përket realizimit të masave (aktiviteteve) procesi i monitorimit është kryer për çdo qëllim politikash (qasje) të strategjisë, në përputhje me formatin (aneks) të përdorur për mbledhjen e kontributit të raportimit, sipas guidës metodologjike mbi strukturën e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes.

Vlerësimi i progresit të zbatimit të SNKK për këtë periudhë raportimi është kryer nga DPPFA përmes analizës së të dhënave të përcjella nga institucionet raportuese duke iu përmbajtur metodës së analizës së parashikuar në Vendimin nr.290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “*Për krijimin e Bazës të të Dhënave Shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)*” dhe Urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, “*Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar*”.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “*Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar*”, janë krijuar 8 Grupe Tematike, të cilat janë pjesë e Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Grupi Tematik Antikorrupsion (GTA).²

GMIP do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

² Këtë rol e luan Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;
- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

Në kontekstin e integritit evropian, këto struktura do të luajnë rolin e Komitetit Sektorial Monitorues për projektet IPA, duke siguruar raportimin e monitorimit të fondeve IPA, sipas sektorëve.

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me aktet e sipërcituara dhe strukturës orientuese për monitorimin e strategjive dhe planeve të veprimit.

Së pari, është analizuar zbatimi i masave dhe të aktiviteteve (realizimi i produkteve) duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së aktiviteteve respektive të lidhura me to.

Së dyti, është analizuar realizimi i objektivave specifike përmes përlllogaritjes së shkallës së realizueshmërisë së tyre.

Shkalla e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë.

Kategoria	Niveli i Tolerancës	Pikët (110)
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara	30
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të zbatuara	20
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të zbatuara	35
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të zbatuara	25
Tejkaluar	111 dhe më lart	N/A

Për përlllogaritjen e realizimit të objektivëve specifike sipas arritjes së masave dhe aktiviteteve është përdorur formula si më poshtë³:

$$NR = \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{2 \text{ Masa}} \times 100\%$$

³ Formula është marrë nga guida dhe udhëzuesi strukturor për monitorimin dhe vlerësimin e raporteve të monitorimit të dokumenteve strategjike, IPSIS dhe përshtatur për vlerësimin e masave dhe aktivitete (subjekt i këtij raporti monitorimi).

Niveli tjetër i analizës është ai sipas qëllimeve të politikës (qasjeve). Bazuar në të dhënat e realizueshmërisë për secilin nivel analitik (masa dhe objektiv specifik) është vlerësuar secili nga tre qëllimet e politikave (qasjeve): parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi.

Një vlerësim më i përgjithshëm përmbledhës është kryer gjithashtu për realizimin e strategjisë në tërësi për këtë periudhë raportimi.

Ecuria e progresit në periudhën që monitorohet, klasifikohet në këto kategori⁴:

- **E zbatuar**: Institucionet kanë raportuar statusin “E zbatuar” për ato masa e aktivitete të cilat janë përmbushur.
- **Pjesërisht e zbatuar/Në proces**: Institucionet kanë raportuar statusin “Në proces” për ato masa e aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.
- **E pazbatuar**: Të pazbatuara janë raportuar ato masa e aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa e aktivitete për të cilat nuk është dhënë raportim nga institucionet përgjegjëse.

Matrica e Riskut

Në këtë raport monitorimi është përfshirë edhe një vlerësim dhe identifikim i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për tu adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të SNKK.

Vlerësimi i riskut është bërë në përputhje si me tabelën më poshtë:

Mundësia	E lartë	3	6	9
	E mesme	2	5	8

⁴ Në këtë kolonë jepet statusi i realizimit të masës. Statusi mund të jetë: plotësisht i zbatuar; pjesërisht i zbatuar; ose i pazbatuar. Masa "plotësisht i zbatuar" është masa, objekti i të cilit është realizuar plotësisht, siç përcaktohet në planin e veprimit. Masa "pjesërisht i zbatuar" është ajo masë që është realizuar në shkallën nga 51 deri në 90 për qind. Masa "i pazbatuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind. Për të treguar statusin përdoret statusi i shkruar dhe kodet e ngjyrave. Qeliza e masës plotësisht të zbatuar theksohet me ngjyrë **të gjelbër**. Kolona e masës të zbatuar pjesërisht theksohet me ngjyrë **të verdhë**. Kolona e masës të pazbatuar theksohet me **të kuqe**.

	E ulët			
		1	4	7
		E ulët	E mesme	E lartë
		Ndikimi		

Konsultimi publik

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit Ministria e Drejtësisë e dërgoi dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtësia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit.

Drafti është dërguar për vlerësim paraprak edhe pranë Departamentit të Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në Kryeministri, në rolin e ‘vlerësuesit’ të raportit të monitorimit, i cili ka përcjellë komente për vlerësim dhe plotësim të raportit, *via email* në datë 6.5.2021.

Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kreu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit të dërguara nga institucionet dhe OSHC.

Një tryezë dy-ditore konsultimi me prezencë të të gjithë përfaqësuesve të institucioneve raportuese u zhvillua gjatë muajit prill 2021 (13 e 14 prill 2021) për të diskutuar mbi metodologjinë e monitorimit të kryer, vlerësimin dhe analizën e informacionit të marrë, problematikat dhe sfidat, me pjesëmarrje përfaqësues të institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kreu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e takimit të sekretariatit teknik për të diskutuar për analizën e kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimin të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit dhe të Kryeministrisë, në 8 qershor 2021.

Në përfundim, sekretariati teknik pranë GT për antikorrupsionin (Sektori i programeve në fushën antikorrupsion) paraqet draftin për diskutim e miratim në mbledhjen e Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023. Pas miratimit të draft raportit të monitorimit, *janar – mars 2021*, paketa e plotë e raportit dërgohet në Sekretariatit e Përgjithshëm të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administrim Publik. Raporti i miratuar i monitorimit publikohet në faqen e internetit të www.drejtësia.gov.al, së bashku me një relacion konsultimi për procesin e ndjekur nga iniciimi deri në finalizimin/miratimin e tij.

PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit 2015-2023 ka si synim arritjen e objektivave madhorë të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete antikorrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfituar rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e SNKK 2015-2023, është hartuar raporti periodik i radhës, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2020– 2023, i cili mbulon periudhën *1 janar deri më 31 mars 2021*.

Masa dhe aktivitete të implementuara me sukses në periudhën përkatëse

Qëllimet e politikave (qasjet) dhe objektivat specifike bëhen të realizueshëm nëpërmjet masave dhe aktiviteteve të parashikuara (produkte), të parashikuara për zbatim, nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpunëtore të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit.

SNKK ka **tre qëllime kryesore politikash** (qasje) përmes të cilave synon të përmbushë vizionin e saj dhe 18 objektiva specifike.

Duke aplikuar të njëjtën formulë⁵ të vlerësimit të shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të qëllimeve të politikës dhe pjestuar me numrin e tyre – realizueshmëria e qëllimit strategjik ndërinstytucional kundër korrupsionit është 53.4%.

Qasja Parandaluese (A)	58.33%
Qasja Ndëshkuese (B)	46.6%
Qasja Ndërgjegjësuere (C)	55.25%

Vërehet se Qëllimi i Politikës I (Qasja Parandaluese A) paraqet një trend pozitiv kundrejt qëllimeve të tjera me 58.33% nivel realizueshmërie.

Krahasuar me monitorimin e kryer për vitin 2020 Qasja Parandaluese (A) shfaq një trend zbritës me 16.33% më pak, për këtë 3M1 2021, kurse 2 Qasjet e tjera shfaqin trend rritës, konkretisht Qasja B me 26.6% më shumë dhe Qasja C me 12.25% më shumë⁶.

⁵ Shiko footnote 3.

⁶ Raporti nuk mund të ofrojë një analizë krahasueshmërie të detajuar për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (janar-mars 2020), pasi nuk kemi në zbatim të njëjtin plan veprimi, dhe raportet e monitorimit të kryera në atë periudhë nuk kanë përdorur të njëjtën metodologji monitorimi dhe vlerësimi.

Konkretisht sipas 18 objektivave specifike, niveli i realizueshmërisë sipas masave dhe aktiviteteve për zbatim për periudhën e monitorimit, është si më poshtë:

Qasja A	Realizueshmëria
A.1	50.006%
A.2.	66.66%
A.3	100%
A.4	75%
A.5	51.5%
A.6	56%
A.7	30%
A.8	62.5%
A.9	50%
A.10	100%
A.11	0%

Qasja B	Realizueshmëria
B.1	65%
B.2	50%
B.3	- ⁷
B.4	25%

Qasja C	Realizueshmëria
C.1	65.75%
C.2	100%
C.3	0%


Bazuar te niveli i realizueshmërisë së 18 objektivave specifike, kemi trend rritës zbatimi në masat e 4 objektivave, konkretisht A4, A8, B1 dhe C2; vihet re trend zbritës në masat e 9 objektivëve, konkretisht A1, A2, A5, A6, A9, A11, B4, C1 dhe C2 dhe të pandryshuara ngelen masat e 3 objektivave, konkretisht A10, B2 dhe C3, (B3 është i parashikuar për zbatim në tremujorin e dytë të 2021). Ky vlerësim është bërë duke marrë në konsideratë nivelin e realizueshmërisë (në përqindje) të objektivave në raportin vjetor 2020 përkundrejt realizueshmërisë së masave dhe aktiviteteve për periudhën në monitorim, janar - mars 2021. Sigurisht, kjo nuk është një bazë e mirë krahasimi por qëllimi i krahasueshmërisë së përdorur është për të identifikuar ecurinë e zbatimit të planit të veprimit, mbështetur vetëm tek këto të dhëna, masa dhe aktivitete, të planifikuara për zbatim në planin e veprimit, për këtë periudhë raportimi.

Plani i Veprimit 2020 – 2023, për vitin 2021 parashikon zbatimin e 118 aktivitete e 67 masa, të shpërndara përkatësisht në 65 aktivitete e 36 masa për Qëllimin e Politikës I (qasjen parandaluese A), 32 aktivitete e 22 masa për Qëllimin e Politikës II (qasjen ndëshkuese B) dhe 21 aktivitete e 9 masa për Qëllimin e Politikës III (qasjen ndërgjegjëse C).

Për këtë periudhë monitorimi, *janar - mars 2021*, rezulton se janë parashikuar për zbatim 106 aktivitete dhe 60 masa, nga të cilat: 103 aktivitete e 59 masa janë vijuese/në vazhdim nga periudha e vitit të mëparshëm (2020), 3 aktivitete dhe 1 masë janë të reja/që kanë filluar zbatimin në këtë tre-mujor të parë të vitit 2021.

⁷ Për këtë objektiv, nuk ka masa dhe aktivitete për zbatim për 3M1 2021.

Qëllimet e Politikës (Qasja)	Aktivitetet dhe Masat	Aktivitete dhe Masa, janar – mars 2021			
		Aktivitete dhe Masa të parashikuara për vitin 2021	Aktivitete dhe Masa të parashikuara për 3M1 2021	Aktivitete dhe Masa në vijim ⁸	Aktivitete dhe Masa të reja ⁹
Parandaluese	Masa	36	31	30	1
	Aktivitete	65	57	55	2
Ndëshkuese	Masa	22	20	20	0
	Aktivitete	32	29	29	0
Ndërgjegjësuere	Masa	9	9	9	0
	Aktivitete	21	20	19	1
Total	Masa	67	60	59	1
	Aktivitete	118	106	103	3




Rezulton se institucionet përgjegjëse vijojnë proceset e tyre për kryerjen e aktiviteteve dhe masave për arritjen e vlerave vjetore të performancës sic mund të evidentohen, kryesisht janë aktivitetet dhe masat nën objektivat A1, A2, A3, A4, pjesërisht A5, pjesërisht A8 e A9, A10, B1, B4, C1 e

⁸ Aktivitete dhe masa që e kanë nisur zbatimin në periudhat e mëparshme të vitit 2020 dhe vazhdojnë zbatimin e tyre dhe në këtë tremujor të 2021

⁹ Aktivitete dhe masa që e nisin zbatimin e tyre në këtë tremujor të 2021

C2. Gjithashtu, aktivitete dhe masa që fillojnë nga zbatimi (për herë të parë) në këtë periudhë monitorimi janë ata në objektivet A4, A5 dhe A8 e A9.

Statusi i masave dhe aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):



Progresi total i arritur në kuadër të përmbushjes së tre qëllimeve të politikës (qasjeve) të strategjisë lidhur me statusin e zbatimit të aktiviteteve dhe masave është si më poshtë:

- 27 masa e 51 aktivitete të zbatuara;
- 15 masa e 17 aktivitete ende në proces zbatimi;
- 18 masa e 38 aktivitete të pazbatuara.

Përsa më sipër, nga **27 masa e 51 aktivitete të zbatuara** për tremujorin e parë të vitit 2021, konkretisht 14 masa/29 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 9 masa/14 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 4 masa/8 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).

Nga **15 masa e 17 aktivitete të cilat janë ende në proces zbatimi** për tremujorin e parë të vitit 2021, konkretisht 9 masa/10 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 3 masa/3 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 3 masa/4 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).


Nga **18 masa e 38 aktivitete të pazbatuara** për tremujorin e parë të vitit 2021, konkretisht 8 masa/18 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 8 masa/12 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 2 masa/8 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).

Statusi i aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

Nga totali prej 106 aktiviteteve të parashikuara për zbatim në *janar – mars 2021*, 57 prej tyre i përkasin Qasjes A, 29 aktivitete i përkasin Qasjes B, si dhe 20 aktivitete Qasjes C.

Statusi i aktiviteteve në Planin e Veprimit 2020 - 2023, për periudhën janar-mars 2021				
Progresi i aktiviteteve	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (Ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjësuere)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	29	14	8	51
Në proces	10	3	4	17
Pazbatuar	18	12	8	38
Totali	57	29	20	106

Statusi i aktiviteteve për periudhën Janar-Mars 2021



Rezulton se nga 106 aktivitete të parashikuara për periudhën *janar – mars 2021*, aktivitete në vijim dhe të reja, statusi i tyre për të 3 qasjet është raportuar si më poshtë:

- 51 aktivitete të zbatuara;
- 17 aktivitete janë ende në proces zbatimi;
- 38 aktivitete të pazbatuara nga institucioni përgjegjës (nga ku mund të përmendim A.1.1.2; A.4.2.2; A.4.4.1; A.4.4.2; A.6.1.1; A.6.1.2; A.6.2.2; A.6.4.2; A.6.5.3; A.7.1.2; A.7.1.3; A.7.1.4; A.7.2.1; A.7.2.2; A.7.2.3; A.8.7.1; A.11.2.1; A.11.3.1; B.1.3.1; B.1.4.1; B.1.10.1; B.2.3.1; B.2.3.4;


B.2.4.1; B.2.4.2; B.2.5.1; B.4.1.2; B.4.3.1; B.4.4.1; C.3.1.2, C.3.1.3; C.3.1.4; C.3.1.5; C.3.1.6; C.3.2.1; C.3.2.2 dhe C.3.2.3.)

Statusi i masave që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

Nga totali prej 60 masash të parashikuara për zbatim në *janar – mars 2021*, 31 prej tyre i përkasin Qasjes A, 20 masa i përkasin Qasjes B, si dhe 9 masa Qasjes C.

Statusi i masave në Planin e Veprimit 2020 - 2023 për periudhën janar-mars 2021				
Progresi i masave	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (Ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjësuere)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	14	9	4	27
Në proces	9	3	3	15
Pazbatuar	8	8	2	18
Totali	31	20	9	60

Statusi i masave për periudhën Janar-Mars 2021



Rezulton se nga 60 masa të parashikuara për periudhën *janar – mars 2021*, masa në vijim dhe të reja, statusi i tyre për të 3 qëllimet e politikës (qasjet) është raportuar si më poshtë:

- 27 masa të zbatuara;
- 15 masa janë ende në proces zbatimi;

- 18 masa të pazbatuara nga institucioni përgjegjës (nga ku mund të përmendim A.1.1; A.4.2; A.6.1; A.7.2; A.7.3; A.8.7; A.11.2; A.11.3; B.1.3; B.1.4; B.1.10; B.2.4; B.2.5; B.4.2; B.4.3; B.4.4; C.3.1 dhe C.3.2.)

Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur masat dhe aktivitetet:

Mbështetur në informacionin mbi raportimin dhe vlerësimin e aktiviteteve dhe masave të zbatuara¹⁰, realizimi i objektivëve për *janar - mars 2021*, është si më poshtë.

Dobët - 4 objektiva (objektivi: A.7; A.11; B.4 dhe C.3)

Mjaftueshëm - 3 objektiva (objektivi: A.1; A.9 dhe B.2)

Mirë - 7 objektiva (objektivi: A.2; A.4; A.5; A.6; A.8; B.1 dhe C.1)

Shumë mirë - 3 objektiva (objektivi: A.3; A.10 dhe C.2)

Tejkaluar – N/A objektiva.

Histori suksesi (përmes masave prioritare)

Ecuria e arritur në kuadër të përmbushjes së aktiviteteve dhe masave të parashikuara, për periudhën e monitorimit, *janar – mars 2021*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015- 2023, është si më poshtë vijon:

- Agjencia e Prokurimit Publik ka vijuar me forcimin e kapaciteteve të stafit teknik, 3 persona, mbi aktivitete operacionale të saj, të zhvilluara online (webinare) dhe në sesione informuese mbi kuadrin ligjor të fushës; është nxjerrë 1 rekomandim për autoritetet kontraktore – (objektivi A2).
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit vijon shtimin e shërbimeve elektronike me një numër total prej 1 207, me 186 e-shërbime; numri i përdoruesve të regjistruar 1 938 002 dhe numri i aplikimeve (portali +moduli) 11 646 773 si edhe me kryerjen e zhvillimeve teknike; janë gjeneruar 11 354 513 dokumente me vulë elektronike dhe 91 134 dokumente me nënshkrim elektronik. E-shërbime e shtuara për këtë periudhë janë në fushën e gjendjes civile, turizmit, kulturës e arteve, financave dhe ekonomisë, shërbimit social, veprave penale të konsumuara gjatë regjimit komunist, arsimit, punëve të jashtme, shëndetësisë, infrastrukturës dhe energjisë. – (objektivi A3).
- Viojnë bashkëpunimet e ndërsjellta PSH-SHCBA me qëllim trajtimin e denoncimeve kundër korrupsionit, 1 rast i përbashkët i PSH me SHCBA e finalizuar në DVP Korçë, ku janë arrestuar 5 shtetas nga të cilët 2 janë punonjës policie dhe ka kryer 2 trajnime me 40 përfitues të zhvilluar nga Pameca dhe Prokuroria e Përgjithshme me temë Pastrimi parave dhe hetimi financiar e pasuror dhe Veprat penale që lidhen me detyrën. SHCBA-ja vazhdon me monitorimin/gjurmimin e rasteve nëpërmjet përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjes Moduli i Ankesave/Moduli i Hetimit Procedural Penal dhe nga Linja e Gjellbër ka marrë 1 328

¹⁰ Objektivi B3, nuk është vlerësuar sepse nuk ka masa dhe aktiviteteve për zbatim direkt në 3M1 2021.

telefonata. Në nivel qendror dhe vendor ka administruar 323 ankesa të ardhura pranë Shërbimit, nga të gjitha portat e komunikimit të vëna në dispozicion dhe nga hetimet administrativ ka rezultuar se në 20 raste për 35 punonjës policie, për shkeljet e evidentuara është sugjeruar fillimi i ecursisë disiplinore nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, në Policinë e Shtetit. – (objektivi A4).

- Gjatë 3-mujorit të parë 2021 ILDKPKI në bashkëpunim me kompaninë që siguron mirëmbajtjen e sistemit ka hartuar dhe miratuar një plan konkret pune me hapat e nevojshme që duhet të merren për të garantuar që sistemi të jetë tërësisht operacional. Aktualisht është ndërmarrë komunikimi zyrtarë me të gjitha Autoritetet Përgjegjëse pranë institucioneve publike dhe janë mbledhur të dhënat e nevojshme për të ngritur regjistrin elektronik të tyre. Për më tepër, janë zhvilluar modulet e nevojshme për të filluar pilotimin fillimisht pranë Inspektoratit të Lartë, si dhe janë zhvilluar takime me partnerët ndërkombëtarë që do të mbështesin aktivitetet për trajnimin e autoriteve përgjegjëse, subjektet deklarues dhe ndërgjegjësimin për funksionimin e sistemit. – (objektivi A5)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ndryshuar formatin e raportimit të monitoruesve në përputhje me ndryshimet ligjore, janë përditësuar/ndryshuar/shtuar udhëzimet në lidhje me raportimin financiar të monitoruesve; është vijuar me forcimin e kapaciteteve (trajtime) të 64 monitorues (32 femra dhe 32 meshkuj) për asimilimin në mënyrën e duhur të formatit të ndryshuar. - (objektivi A6).
- Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë kanë filluar me procesin e vlerësimit të riskut të integritetit, në përputhje me dokumentin “Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet Qendrore” nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë; Janë ngritur grupet e punës institucionale në DPB, DPP, DPSHP, ATP, QBZ, IML, DNJF, KSHB, SHKBB dhe ASHSGJ, për vlerësimin e riskut të integritetit, evidentimin e rasteve që përbëjnë risk për korrupsion dhe hartimin e PI; MD ka zhvilluar dy takime informuese/ndërgjegjëse me përfaqësues e punonjës së varësive të MD - (objektivet A8 e A9);
- Është kryer mbledhja e të dhënave dhe administrimi i informacioneve statistikore për veprimtarinë e institucioneve ligjzbatuese kundër korrupsionit dhe asetëve të konfiskuara të dhëna statistikore të harmonizuara, nga institucione si; Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, SPAK, AAPSK, gjykatat, të dhëna që do të jenë pjesë e Vjetarit Statistikor 2020; të dhënat statistikore janë mbledhur e harmonizuar edhe për krimin e organizuar; Gjithashtu është mbledhur e përcjelle informacion statistikor mbi numrin dhe vlerën e rasteve të veprave penale të korrupsionit sipas kërkesës së Komisionit Evropian pranë MEPJ - (objektivi A10).
- Janë zhvilluar trajnimet online në stafet e institucioneve ligjzbatuese, me temë “Pastrimi i parave dhe hetimi pasuror dhe financiar” 68 pjesëmarrës dhe trajnimi “Mbi veprat penale që lidhen me detyrën”, me 80 pjesëmarrës, është vijuar me forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve online me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit, këtyre të fundit dhe gjyqësorit, me 40 përfitues (36 meshkuj dhe 4 femra); Është kryer një trajnim një ditor me temë “Lufta kundër tregtimit të paligjshëm të flukseve monetare” ku kanë marrë pjesë 10 administratorë 3 femra dhe 7 meshkuj, parterë të fushës (GIZ Albania);
- Të dhëna statistikore për korrupsion: SPAK- janë hetuar gjithsej 161 procedime me 75 persona ne hetim, janë bashkuar me procedimet e tjera 4 procedime për veprat penale që lidhen me korrupsionin. Pas bashkimit të procedimeve rezulton që më 31 mars 2021 janë hetuar gjithsej 157 procedime me 75 persona ne hetim; të dhëna statistikore për procedime për korrupsion: janë dërguar në gjykate 6 kërkesa për gjykim me 11 të pandehur, 3 kërkesa për

pushim me 2 të pandehur, është pezulluar 1 procedim dhe janë transferuar për kompetencë ne Prokuroritë e Rretheve 3 procedime me 7 persona ne hetim.- (objektivi B1).

- Të dhëna statistikore për raste ndëshkimore nga Polici e Shtetit dhe SHCBA: 39 referime penale për 67 subjekte, nga të cilët: 21 punonjës policie të nivelit të parë drejtues; 45 punonjës policie të nivelit zbatues; 1 efektivë i Gardës dhe 9 shtetas. Operacione të sukseshme të hetimeve proaktive të kryera: 4 operacione për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së punonjësve të policisë në format dhe fenomenet më shqetësuese, siç janë *“korrupsioni pasiv”*, *“shpërdorimi i detyrës”*, *favorizimi i “kultivimit të bimëve narkotike” e “kontrabandës”*, *“ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit” etj.*
- Vijon bashkëpunimi i institucioneve ligjzbatuese me SPAK, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë dhe strukturave të Policisë së Shtetit, duke u finalizuar me dokumentimin me prova ligjore të veprimtarisë së kundërligjshme të 8 punonjësve të policisë dhe 25 shtetasve të implikuar, si dhe ekzekutimit të masave të sigurimit personal shtrëngues dhe ndalues të dhëna për ta si subjekte të procedimeve penale në ndjekje, nga Gjykata e Posacme dhe ato të Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë; janë zbatuar vendime të gjykatave për masat *“Arrest në flagrancë/ndalime/masa sigurie”*, ndaj 33 personave, ku 11 subjekte të Shërbimit dhe 22 shtetas janë arrestuar/ndaluar dhe nga 30 persona janë 4 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 7 punonjës policie të nivelit zbatues, 19 shtetas dhe me masa të tjera të sigurimit personal, si; *“pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”* janë 3 persona/shtetas të cilët kanë masë *“detyrim paraqitje tek OPGJ”* – (objektivi B1).
- Është lidhur marrëveshje bashkëpunimi Prokurori e Përgjithshme - me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë *“Për kryerjen e inspektiveve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”* dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve *“Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në bazën e të dhënave menaxhimi i informacionit të sistemit penitenciar”* e cila është në proces aksesimi teknik. - (objektivi B2).
- Ka pasur shkëmbim informacioni midis Policisë së Shtetit me INTERPOL 117 praktika, me EUROPOL 56 praktika, marrëdhënie ndërkombëtare 44 praktika. - (objektivi B4).
- MD/KKK ka vijuar me bashkërendimin për pasjen e një plani vjetor vizibiliteti dhe komunikimi në fushën AK, për vitin 2020; në proces draftimi një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ambasadës së Italisë në Shqipëri me shoqatën *“Avviso Pubbico”* për promovimin e përbashkët të një projekti pilot didaktik-edukativ (moduli antikorrupsion) për mësuesit e arsimit të mesëm e të ulët; është kryer promovimi dhe njohja me publikun e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion në 8 institucione; është vijuar me forcimin e kapaciteteve (trajnime) për rrjetin e koordinatorëve antikorrupsion dhe 2 trajnime për stafin e drejtorisë AK, nga DBE; është kryer në transparencë të plotë publikimi i raporteve të monitorimit (përfshirë draftet për konsultim) në faqen zyrtare të MD me vijueshmërinë rregullisht të konsultimit të dokumenteve AK në rrjetin e organizatave në fushën antikorrupsion - (Objektivi C1).
- Janë përmirësuar proceset në sistemin elektronik të platformës së bashkëqeverisjes, www.shqiperiaqeduam.al, duke mundur gjurmimin dhe etiketimin elektronik të rasteve të dyshuara si korruptive; janë regjistruar 7 057 çështje, kërkesa, ankesa, nga të cilat 5 052 përkasin autoriteteve në nivel qendror dhe 1 253 në nivel vendor dhe 752 janë për çështje biznesi. Në faqet zyrtare të Platformës së Bashkëqeverisjes publikohen minimalisht 2 postime në javë, me anë të të cilave, promovohet puna e kryer nëpërmjet rasteve të suksesit ose raporteve si dhe orientohen qytetarët se si mund të aplikojnë në platformë – (Objektivi C2).

EKZEKUTIMI I BUXHETIT

Sipas SNKK, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve e masave të Planit të Veprimit 2020 - 2023, edhe për këtë periudhë institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e përdorur në bazë të performancës së kryer.

Buxheti i përdorur i sjellë nga institucionet kontribuese dhe burimi konkret i financimit sipas objektivëve është si vijon:

A1: 1.129.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A2: 26.223.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A4: 3.598.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A6: 1.914.000 lekë, mbuluar nga donatorë, 4.800.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A7: 6.174.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A8: 549.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A9: 114.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A10: 178.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

B1: 65.244.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

C1: 144.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

Objektivët A3, A5, A11, B2, B4, C2 e C3 nuk kanë raportuar kosto të përdorur (0).

Buxheti i ndarë sipas qëllimeve të politikës/Qasjeve A-B-C, është:

Qëllimi i politikës I (qasja parandaluese - A)

42.765.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

1.914.000 mbuluar nga donatorë

Qëllimi i politikës II (qasja ndëshkuese - B)

65.244.000 mbuluar nga buxheti i shtetit.

Qëllimi i politikës III (qasja ndërgjegjësuere - C)

144.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

Nga analiza për aktivitetet dhe masat e raportuara në mënyrë progresive, për periudhën *janar – mars 2021*, buxheti i planifikuar për këtë periudhë monitorimi është 1,117,337,000 lekë.

Ndërkohë totali i buxhetit të përdorur për këtë vit është:

- Financimi për këtë periudhë monitorimi nga buxheti i shtetit është në shumën 108,153,000 lekë.
- Financimi nga donatorët është në shumën 1,914,000 lekë.

Shumë aktivitete të kryera gjatë kësaj periudhe raportimi janë në “kosto administrative”, të mundësuar dhe mbuluara nga kapacitetet njerëzore dhe financiare të institucioneve zbatuese, duke mos paraqitur kosto shtesë për institucionet zbatuese, në përputhje edhe me parashikimin e bërë në Planin e Veprimit. Kështu në total, janë 9 aktivitete që raportohen të jenë kryer me “kosto administrative” dhe 7 aktivitete me 0 (zero) kosto.

Për këtë periudhë monitorimi, *janar – mars 2021*, vijon të ketë institucione që nuk kanë pasur mbështetje financiare dhe në këtë mënyrë është ndikuar edhe zbatueshmëria e masave/aktiviteteve, përmendim objektivin C3, i cili vijon në jetë në gjendjen e mospasjes së buxhetit për të zbatuar aktivitetet dhe masat e parashikuara. Është akoma i nevojshme mbulimi i burimeve financiare të munguara për të ardhmen.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer, rezulton se për periudhën *1 janar – 31 mars 2021*, fushat që kanë treguar performancë por edhe shoqëruar nga problematika janë aktivitete dhe masa të shpërndara në të gjithë objektivët specifikë në të tre qëllimet e politikës (qasjet) e SNKK, parandalim (A) – ndëshkim (B) – ndërgjegjësim (C).

Institucionet kanë dëshmuar vazhdimësi, përpjekje dhe vullnet për të zbatuar masat, kryer aktivitetet në funksion të tyre, në përputhje me buxhetet e parashikuara në planin e veprimit, mbështetjet e partnerëve ndërkombëtarë dhe vendas; si dhe janë mbështetur në burimet e tyre njerëzore dhe kapacitetet teknike profesionale të brendshme.

Në adresimin e performancës nga institucionet rezulton se mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale dhe pse e parashikuar për tu shtuar në kohën e parashikimit të masave në planin e veprimit); mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar; vonesa në miratimin e akteve të tjera; mosraportimi nga institucionet përgjegjëse duke ndikuar në kryerjen e një analizë reale dhe të saktë të zbatueshmërisë së planit të veprimit janë arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

Periudha *janar – mars 2021*, gjithashtu përkoi me situatën e vështirë shoqërore me efekt global Pandemia Covid-19, e cila përsëri pati ndikim në mbarëvajtjen e aktiviteteve institucionale dhe ndërinstitutionale në vend në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2020-2023.

Nga raportimet e ardhura, masa të parashikuara në objektivët specifikë A5, A11 dhe B1 janë të ndikuar drejtpërdrejtë nga pengesa e shkaktuar nga Covid-19.

Rekomandime

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për vijueshmërinë e zbatimit të planit të veprimit janë:

- të fillojë kryerja e aktiviteteve dhe masave për 4 objektivë të strategjisë, që rezultojnë në nivelin e zbatimit dobët (*nga 0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara*), përkatësisht objektivët A7; A11; B4 e C3.

- të vijojë e të përmirësohet performanca e kryerjes së aktiviteteve dhe masave për 3 objektive të strategjisë me synim arritjen e vlerës vjetore të treguesit të performancës, që rezultojnë në nivelin e zbatimit mjaftueshëm (nga 31 në 50 për qind e masave të zbatuara), përkatësisht për objektivet A1; A9 e B2.
- të përmirësohet performanca e aktivitetit të institucioneve që raportojnë aktivitete e masa në proces zbatimi;
- të raportohet informacioni mbi buxhetin e përdorur për masat e planit të veprimit, buxheti i shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga donatorët (informacion i cili nuk disponohet nga të gjitha pikat e kontaktit pranë institucioneve raportuese); buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga buxheti i shtetit e të krijohet një bashkëpunim më i mirë për qëllime raportimi me strukturat/stafet teknike të financës/buxhetit pranë institucioneve raportuese, pasi në kuadër të raportimit kjo është një përgjegjësi e pikave të kontaktit antikorrupsion. Rezulton se ka ende institucione përgjegjëse për zbatimin e këtij plani veprimi, që nuk kanë raportuar informacionin mbi buxhetin e përdorur (referohu aneksit të draft raportit);
- të raportohet në përgjigje të kërkesës së raportimit nga pikat e kontaktit antikorrupsion, sepse mosraportimi ndikon në kryerjen e një analizë reale dhe të saktë të zbatueshmërisë së planit të veprimit;
- të evidentohet nga institucionet raportuese në kuadër të raportimit të ardhshëm 6 muajor 2021, se cilat janë pengesat e mundshme në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2020-2023, (psh mungesa e burimeve njerëzore; mosparashikimi i elementëve të caktuar në kohën e parashikimit të masave në planin e veprimit; mungesa e buxhetit për disa aktivitete; vërshtirësia në trajnimin e stafit; vërshtirësi në koordinimin mes institucioneve etj),
- të bëhet me dije nga institucioni përgjegjës nevoja për asistencë teknike lidhur me aktivitete specifike që janë ende në proces zbatimi apo aktivitetet e pazbatuara, në kuadër të objektivit të arritjes së vlerës vjetore të treguesit të performancës,
- të vijojë raportimi në përputhje me metodologjinë *SIP/IPSIS* për periudhën në vijim.

Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Rezulton se ndër objektivet me mungesë të plotë realizueshmërie për periudhën raportuese, *janar – mars 2021*, janë disa prej objektivëve në të tre Qëllimet e Politikave (qasjet) e SNKK, përmendim përkatësisht, objektivet A7, A11, B4, C3.

Në këtë raport ka një mungesë informacioni për masa dhe aktivitete që rezultojnë të paraportuara, përmendim përkatësisht objektivet A7, A11, B1-B4.

Për periudhat në vijim të zbatimit të Planit të Veprimit rekomandohet të merren masa për përmirësim në përputhje me realizimin e 16 objektivëve të SNKK, pasi objektivi A3 e A10, rezultojnë që në tre-mujorin e parë të zbatuara.

Vlerësimi i riskut duke përdorur masat dhe aktivitetet

Në këtë raport monitorimi, *janar – mars 2021*, është kryer edhe një vlerësim i riskut për çdo objektiv në përputhje me nivelin e realizueshmërisë së tij.

Ndër risqet që u evidentuan kryesisht, janë të lidhura me kapacitetet institucionale, kapacitetet financiare, mjedisin rregullator, partneriteti dhe bashkëveprimi institucional, komunikimi, proceset e punës por dhe faktorë të tjerë të jashtëm.

Pandemia Covid-19, është një risk i shtuar që ka rritur impaktin e saj negativ mbi objektivet strategjikë dhe duke u kthyer në pengesë kryesore për progresin e tyre.

Objektivët të cilat paraqesin një nivel të lartë risku janë objektivat A2, A4, A11, B1, B2, B3, C2 dhe C3.

Objektivi A2 ka një nivel të lartë risku përkundrejt shkallës së mirë së realizueshmërisë, kjo për shkak të vonesave në miratimin e ligjit të ri të prokurorit në zbatim të të cilit do të miratohen akte të tjera nënligjore.

Objektivi A4 risku për këtë objektivi është i lartë dhe lidhet me proceset dhe sistemin. Policia e Shtetit akoma vazhdom me moskrijimin e sistemit të të dhënave të ndara për rastet e hetimit të korrupsionit për të evidentuar veçmas hetimet për korrupsion të iniciuara përmes denoncimeve të qytetarëve.

Objektivi A11 vazhdon të ketë riskun e realizimit të lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me komunikimin dhe informimin, me çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ.

Objektivët B (B1-B4) vazhdojnë të kenë risk të lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me komunikimin dhe informimin dhe bashkëpunimin ndërinsitucional në përgjithësi, me çështje të tjera që lidhen me kapacitetet administrative dhe mjedisin rregullativ dhe për shkak të ndikimit të pandemisë.

Objektivi C2 Përkundrejt shkallës së mirë së realizueshmërisë vazhdon të ketë risk të lartë për shkak të rreziqeve të brendshme të lidhura me proceset, sistemin si dhe rreziqe që lidhen me koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinsitucional.

Objektivi C3 ka një nivel të lartë risku për shkak të rreziqeve të brendshme të lidhura me proceset financiare dhe shpërndarjen e fondeve bazuar te ngërci që është krijuar midis zbatimit të misionit të AMSHC-së dhe vendimit të KQZ-së mbi projektet, grantet dhe financimet publike.

Në përfundim, të gjitha institucionet zbatuese të këtij plani veprimi, duhet të marrin në konsideratë këtë analizë dhe të shtojnë përpjekjet për zbatimin e masave dhe aktiviteteve duke pasur si prioritet arritjen e vlerave të treguesve të performancës për të arritur qëllimin e objektivëve specifike. Në

raportin e monitorimit, janar – qershor 2021, do të ketë një analizë të shtuar të treguesve të performancës¹¹.

Hapat e rradhës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar-mars 2021*, të gjetjeve që ky raport na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen të ndërmerren këto hapa në vijim:

A1: Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion:

Me hyrjen në fuqi dhe fillimin nga zbatimi të modelit të ri të Programit të Transparencës në institucionet e qeverisjes qendrore dhe varësitet, të monitorohet zbatimi i tyre edhe të prodhohen raporte të sistemit të transparencës, me qëllim realizimin e vlerës së synuar për vitin 2021 si dhe të përmirësohet instalimi i e-regjistrave të kërkesave-përgjigjeve.

A2: Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore:

Të vijohet me ecurinë e hartimit dhe miratimit të akteve rregullatore të mekanizmave për planifikimin, zbatimin dhe pregatitjen e dokumenteve të procedurave të tenderave publikë.

A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit:

Policia e Shtetit dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje duhet të përmirësojë procesin e brendshëm të menaxhimit të rasteve në mënyrë që të ndajë rastet e hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve nga ato të gjeneruara përmes formave të tjera.

Të mundësohet bashkëpunimi PSH-ADB në portalin shqipëriaqeduam.al për korrupsion dhe të mundësohet akses i PSH në platformë si një formë që do të përmirësonte dhe do të garantonte një bashkëveprim funksional për trajtimin e denoncimeve kundër korrupsionit, në mënyrë që të rritet edhe ndërgjegjësimi qytetar për të denoncuar krimin e korrupsionit në mënyrë konkrete dhe të drejtpërdrejtë.

A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave:

Deklarimi online i pasurive të subjekteve deklarues të fillojë nga zbatimi sipas parashikimit ë bërë për vitin 2021.

¹¹ Në baza 6 mujore maten 6 tregues, ata janë: A.1.a; A.2.a; A.2.b; A.2.c; A.7.b dhe A.10.

A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike:

KQZ duhet të vijojë me publikimin e raporteve të kontrollit të financave të partive politike.

A7: Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut:

Të përmirësohet raportimi për objektivin përgjegjës si dhe për zbatimin e masave dhe aktiviteteve si dhe të përcillet informacioni për treguesin e performancës (A7.c) të munguar në raportin vjetor të monitorimit 2020.

A8: Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion:

Të vijojë procesi i vlerësimit të riskut të integritetit në të gjithë institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

A9: Forcimi i integritetit të nëpunësve publik:

Të vijojë procesi i hartimit të planeve të integritetit në të gjithë institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

A.11 Adaptimi i politikave antikorruption në nivelin e qeverisjes vendore:

Të forcohet mjedisi i brendshëm mbi komunikimin dhe informimin për politikën e zhvillimit në pushtetin vendor (bashkitë) në drejtim të instrumenteve/mekanizmave antikorruption sic janë planet e integritetit.

B1: Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit:

Të forcohen dhe përmirësohen komunikimi, informimi dhe bashkëpunimi ndërinsitucional midis organeve ligjzbatuese, dhe të forcohen kapacitetet administrative respektive.

B2: Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkrimin penal të korrupsionit:

Të bashkëpunimi ndërinsitucional, të rritet aksesimi në bazat e të dhënave nga institucionet ligjzbatuese. Të përmirësohet raportimi për objektivin përgjegjës

B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar:

Të vijojë zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve me qëllim ngritjen e ZRA në afatet e parashikuara.

B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit:

Të vijohet me kryerjen e trajnimeve të përbashkëta, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare si dhe me ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin e korrupsionit.

C2: Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit:

Platforma e bashkëqeverisjes duhet të krijojë mundësinë e dërgimit të rasteve të denoncimit të korrupsionit pranë Policisë së Shtetit.

C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile:

Të sigurohet mbështetja financiare për ecurinë e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit dhe të sigurohet më shumë prezencë e organizatave të shoqërisë civile në hartimin e programeve antikorruption.

